



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2682, datë 07.07.2016

Për

**“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Recj, në mbledhjen e datës 07.07.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik”*

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik”

## BAZA LIGJORE:

1. Nenet 31 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
2. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;

## K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

## V Ë R E N:

1. AKEP nëpërmjet Vendimit nr.2681, datë 8.06.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Keshillim Publik*”. Periudha e këshillimit publik e dokumnetit të Analizës së Tregut është 15.06-15.08.2016.
2. Në lidhje me masat rregulluese, AKEP në dokumentin e analizës së tregut të cituar në pikën 1 më sipër, ka propozuar që dy sipërmarrësit, Albtelecom dhe ATU, të kenë detyrime për FNT si mos-diskriminim, transparencë, dhënie aksesit si edhe detyrimin për kontroll dhe rregullim të tarifave të shërbimeve të ofruara në tregjet përkatës në të cilat propozohen të kenë status me FNT. Në lidhje me masën rregulluese të kontrollit të tarifave të sipërmarrësve të propozuar për status me FNT, në dokumentin e analizës së tregut të nxjerre në këshillim publik AKEP ka sqaruar se do të zhvillojë një proces të vecantë këshillimi publik, në përputhje me përcaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918, për të përcaktuar metoden e kontrollit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në këto tregje përkatës.
3. Dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i Punës, përbëhet nga:
  - a) Projekt-vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
  - b) Dokumenti “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik*”, i cili në përputhje me nenin 57 të Ligjit 9918, përmban metodat e rregullimit të tarifave me shumicë të sipërmarrësve të propozuar me status me FNT në dokumentin “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Keshillim Publik*”, miratuar nga AKEP nëpërmjet Vendimit nr.2681, datë 6.08.2016;
  - c) Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD dhe dokumentin e rregullimit të tarifave;
4. Dokumenti: “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik*”, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe masat rregulluese që do

të merren në varësi të gjetjeve për FNT sipas dokumentit përkatës të analizës së tregut dhe këtij dokumenti pas procesit të këshillimit publik, kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Referuar bazës ligjore sa mësipër,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik*”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Proçedura e këshillimit publik perfundon me date 15.09.2016.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik*”, të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me  
FNT ne tregjet me shumice te aksesit  
broadband dhe në infrastrukturen aktive dhe  
pasive në rrjete fikse**

**Dokument per Këshillim Publik**

**Miraturar me VKD nr. 2682 datë 07.07.2016**

## Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje .....	4
2.	Tarifat me shumice te aksesit në rrjete fikse nën-rregullim dhe ecuria e tyre ..6	
3.	Tarifat benchmark te aksesit ne rrjete fikse.....	10
	3.1. Tarifat benchmark të aksesit per LLU .....	10
	3.1.1 Tarifat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE .....	10
	3.1.2. Tarifat e aksesit te plote dhe te perbashket ne LLU dhe aksesi ne nen-qark (SLU).....	11
	3.2 Tarifat benchmark te aksesit ne tubacione .....	14
4.	Rregullimi i tarifave me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fikse ne Shqiperi .....	21
	4.1. Tarifat per LLU (Tregu WLA): Albtelecom.....	22
	4.2. Tarifat per aksesin bitstream (Tregu WCA): Albtelecom.....	24
	4.3 Tarifat per Linjat me qira (Tregu WHQA): Albtelecom .....	25
	4.4 Tarifat e aksesit ne Tubacione: Albtelecom dhe ATU.....	25
5.	Efektet e pritshme .....	28
	Aneks 1: Pyetjet e keshillimit publik .....	31
	Aneks 2: Lista e Shkurtimeve të Shteteve .....	32

## Lista e Tabelave dhe Figurave

TABELA 1: TARIFAT E AKSESIT NE RRJETIN LOCAL LLU TE ALBTELECOM (2014) .....	6
TABELA 2: METODA E RREGULLIMIT TE TARIFAVE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM (2014) .....	7
TABELA 3: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM.....	8
TABELA 4: TARIFAT E AKSESIT NE TUBACIONE NE RRJETIN ALBTELECOM .....	9
TABELA 5: TARIFAT E AKSESIT NE RRJETIN LOCAL LLU .....	12
TABELA 6: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE VENDET BE DHE RAJONIT .....	16
TABELA 7: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE VENDET E RAJONIT .....	19
TABELA 8: TARIFAT ME SHUMICE TE ALBTELECOM PER AKSESIN LLU (2017).....	23
TABELA 9: METODA E RREGULLIMIT TE TARIFAVE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM (2016) .....	24
TABELA 10: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM (2016-).....	24
TABELA 11: TARIFAT MAKSIMALE TE AKSESIT NE TUBACIONE PER ALBTELECOM DHE ATU (1.01.2017) .....	26
TABELA 12:: NDRYSHIMI I TARIFAVE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE RRJETIN ALBTELECOM (KABELL 20 MM) .....	27
FIGURA 1: TARIFAT E AKSESIT TE PLOTE NE LLU NË VENDET E BE DHE SHQIPERI (2013 DHE 2016) .....	11
FIGURA 2: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT TE PLOTE NE LLU (2016) .....	13
FIGURA 3: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT TE PERBASHKET NE LLU (2016) .....	13
FIGURA 4: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT TE PLOTE NE SLU (2016) .....	14
FIGURA 5: TARIFAT MINIMALE MUJORE PER AKSES NE TUB .....	17

FIGURA 6:: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE PER AKES NE TUB .....	17
FIGURA 7: TARIFAT AKSESIT LLU NE NEN-RRJETIN LOKAL (2016-2017).....	28
FIGURA 8: TARIFAT MINIMALE MUJORE PER AKSES NE TUB 2016-2017.....	28
FIGURA 9: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE PER AKSES NE TUB 2016-2017 .....	29

# 1. Hyrje

---

AKEP nëpërmjet Vendimit nr.2681, datë 8.06.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Keshillim Publik*”. Periudha e këshillimit publik është 15.06-15.08.2016. Në dokumentin e Analizës së Tregut të nxjerrë në këshillim publik, AKEP kreu një ri-perkufizim të tregjeve perkatese te lidhura me aksesin broadband të analizuar në vitin 2014, duke marre ne konsiderate rekomandimin e vitit 2014 te KE (2014/710/EU) dhe kushtet e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi. Në lidhje me FNT në treg, AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik ka propozuar të përcaktojë:

- Albtelecom sipërmarres me FNT (dominance individuale) ne:
  1. Tregun me shumice te aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (ËLA)
  2. Tregun me shumice te aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (ËCA)
  3. Tregun me shumice te aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (ËHQA);
- Albtelecom dhe ATU sipërmarres me FNT (dominance e bashkuar) ne:
  4. Tregun me shumice te aksesit ne elementet passive te infratsrukturese se rrjeteve ne nivel kombetar

Në lidhje me masat rregulluese, AKEP ka propozuar që dy sipërmarrësit të kenë detyrime për FNT si mos-diskriminim, transparencë, dhënie aksesit si edhe detyrimin për kontroll dhe rregullim të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Albtelecom dhe ATU në tregjet përkatës në të cilat propozohen të kenë status me FNT. Ne lidhje me masen rregulluese te kontrollit te tarifave te sipërmarresve te propozuar per status me FNT, në dokumentin e analizës së tregut të nxjerre në këshillim publik AKEP ka sqaruar se do te zhvilloje nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918, per te percaktuar metoden e kontrollit te tarifave te sipërmarresve me FNT ne keto tregje perkatese.

Në përputhje me sqarimin e cituar, AKEP nxjerr këtë dokument në këshillim publik për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave. Procesi i këshillimit publik të këtij dokumenti

perfundon me date 15 Shtator 2016 dhe do kryhet paralelisht me procesin e këshillimit publik të dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik*”. Versioni final i këtij dokumenti do të miratohet pas miratimit të versionit final të dokumentit të Analizës së Tregut, për të reflektuar ndryshimet e mundshme në përfundimet e AKEP për FNT dhe masat rregulluese të tregjeve të analizuara.



## 2. Tarifat me shumice te aksesit në rrjete fikse nën-rregullim dhe ecuria e tyre

Ne baze te analizes se tregut te nxjerre ne keshillim publik, “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik”, AKEP ka propozuar qe Altelecom te vazhdoje të zbatojë detyrimet e vendosura nga AKEP ne dy dokumentat e analizave të tregut të kryera në vitin 2014. Në lidhje me tarifat e shërbimeve të propozuar të jenë nën-rregullim sipas dokumentit të nxjerrë në këshillim publik, AKEP në këtë seksion paraqet ecurinë e tyre nga analiza e fundit si dhe të tarifave të aksesit në tubacione për Altelecom. Ky seksion është bazuar në informacionin e dokumentit të analizës së tregut, Seksioni II.1.

### **Tarifat e Altelecom për LLU**

Ne lidhje me tarifat per LLU, AKEP në analizën e tregut 2014 vendosi që Altelecom te aplikojë tarifate e miratuara me VKD nr.1365, date 13.04.2011, duke saktësuar qe per linjat e aksesuara ne MSAN per LLU, Altelecom te aplikojë tarifate perkatese te aksesit (te plote dhe te perbashket) në **nën-rrjetin lokal**. Metoda e zgjedhur ishte aplikimi i tarifave maksimale, sipas rezultateve te modelit te kostove BULRAIC ne vitin 2010.

**Tabela 1: Tarifate e aksesit ne rrjetin lokal LLU te Altelecom (2014)**

Shërbimi	Tarifa (Lekë)	Njësia
Pagesa mujore për LLU		<b>Paguhen çdo muaj</b>
Akses i plote në rrjetin lokal (full unbundled access LLU)	<b>801</b>	[per linjë]
Akses i perbashket në rrjetin lokal (shared access LLU)	<b>468</b>	[per linjë]
Akses i plote në nën-rrjetin lokal	<b>678</b>	[per linjë]
Akses i perbashket në nën rrjetin lokal	<b>407</b>	[per linjë]
Pagesa instalimi për LLU		<b>Paguhet vetëm një</b>

		herë
Instalimi i aksesit të plotë në rrjetin lokal	1 686	[per linjë]
Instalimi i aksesit të përbashkët në rrjetin lokal të hapur	2 452	[per linjë]

*Shenim: Tarifat e mësipërme nuk përfshijnë TVSH*

### **Aksesi bitstream**

Në lidhje me aksesin bitstream, AKEP në analizën e tregut 2014 vendosi që tarifat e aplikara nga Albtelecom për këtë shërbim në nivel ATM/Ethernet dhe në nivel IP, pra në layer 2 dhe 3 të rrjetit NGN/NGA, të rregullohen me metodën “retail minus”:

**Tabela 2: Metoda e rregullimit të tarifave të aksesit bitstream të Albtelecom (2014)**

Niveli i aksesit	Cmimi Maksimal
Në nivel ATM/Ethernet;	Tarifa Retail - 50%
Në nivel IP	Tarifa Retail - 30%

*Shenim: Tarifa retail me pakicë pa TVSH*

AKEP njëkohësisht vendosi që tarifa për akses bitstream nuk mund të jetë më e ulët se cmimi për akses në LLU. Në vijim të argumentit në pjesën e analizës për LLU, cmimi (tarifa mujore) për akses bitstream nuk mund të jetë më e ulët se 407 lek/muaj.

Albtelecom pas vendimeve të AKEP në vitin 2014 ka publikuar ofertën referencë të aksesit bitstream dhe ka kryer 2 herë rishikim të tarifave duke bërë reduktime deri në 90% të tyre krahasuar me tarifën fillestare. Për shërbimet e aksesit bitstream, Albtelecom ka lidhur marrëveshje me 4 operatore në 2014-2015. Tarifat e aplikuar nga Albtelecom janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 3: Tarifatat mujore te aksesit bitstream te Albtelecom**

Shpejtesia Doënload	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
<b>2 Mbps</b>	468	421	549	494
<b>4 Mbps</b>	623	560	731	658
<b>6 Mbps</b>	828	745	972	875
<b>8 Mbps</b>	1,101	991	1,293	1,164
<b>10 Mbps</b>	1,266	1,139	1,487	1,338
<b>12Mbps</b>	1,456	1,310	1,710	1,539
<b>16 Mbps</b>	1,675	1,508	1,966	1,769

*Shenim: Tarifatat ne Lek pa TVSH*

### **Linjat me qira**

Ne lidhje me rregullimin e tarifave per sherbimet e aksesit ne Ethernet ne rrjetin NGN dhe rrjet tradicional, AKEP percaktoi si detyrim per Albtelecom qe tarifatat me shumice duhet te jene me te lira se tarifatat e sherbimeve perkatese me pakice. Tarifatat e Albtelecom per kapacitetet me qira Ethernet ne rrjet tradicional dhe Ethernet ne NGN duhet:

- Te mos jene me te larta se tarifatat e tabelës së mesiperme;
- Te jene te pakten 20% me te lira se tarifatat sherbimeve respektive me pakice.

Ne permbushje te detyrimeve rregullatore per transparence dhe mos-diskriminim Albtelecom ne Korrik 2015 perditesoi Oferten Reference, per tarifatat e sherbimit te aksesit te linjave meqira, perditesim ky i cili konsistoi ne nje reduktim te ndjeshem me 70%-90% te tarifave per keto sherbime. Megjithë reduktimet e tarifave edhe per keto sherbime ka pasur interes te ulet nga ana e operatoreve, dhe Albtelecom ka lidhur vetem nje marrveshje me Abcom ne vitin 2015, per kapacitet transmetimi SDH 2xSTM1 dhe 1xE1. Nderkohe interesi me i madh per kapacitete transmetimi rezulton se eshte ne kuader te linjave te interkoneksionit, ku Albtelecom ka dhene kapacitete te linjave me qira per 23 operatore.

### Tarifat e aksesit ne Tubacione te Albtelecom

Tarifat e aksesit ne tubacione nuk kane qene nen-rregullim ex-ante nga AKEP. Ato propozohen te vihen nen-rregullim neprmjet procesite te analizes se tregut, dhe vendimeve perkatese qe do te merren nga AKEP ne perfundim te keshillimit public te dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik”, i publikuar me 15.06.2016.

Tabela e meposhteme paraqet tarifat e aplikuar nga Albtelecom per akses ne tubacione apo perdorim te perbashket te tubacioneve te rrjetit te Albtelecom. Tarifat jane per vendosjen e nje kablli me diameter 20 mm te operatorit perfitues ne tub me diameter 100 mm te Albtelecom.

**Tabela 4: Tarifat e aksesit ne tubacione ne rrjetin Albtelecom**

		<b>Tarife Fillestare</b>	<b>Tarifa Mujore</b>
	Distanca (Km)	Euro/Km	Euro/km Muaj
<b>D1</b>	0.2-1	100	200
<b>D2</b>	1-5	80	160
<b>D3</b>	5-20	80	150
<b>D4</b>	20-40	80	140
<b>D5</b>	40-80	80	130
<b>D6</b>	80-160	80	120
<b>D7</b>	160-300	80	110
<b>D8</b>	>300	80	100

*Shenim: Tarifat ne Euro pa TVSH*

## 3. Tarifat benchmark te aksesit ne rrjete fikse

---

Ky kapitull permban te dhena mbi nivelin e tarifave me shumice te aksesit ne rrjete fikse per LLU dhe tubacione, ne vendet e BE dhe rajonit, si dhe nje krahasim te nivelit mestar te tyre me tarifate aktuale te ketyre sherbimeve ne Shqiperi. Per sa i perket nivelit te tarifave mesatare te aplikuara ne vendet e BE dhe ne rajon, AKEP ka grumbulluar informacion duke i'u referuar burimeve te meposhtme:

- Te dhënat e Komisionit Europian te publikuara per Axxhendën Dixhitale te BE<sup>1</sup> (Telecom sector);
- Te dhëna te publikuara nga Cullen International ne lidhje me tarifate shumice te aksesit ne rrjete fikse

### 3.1. Tarifate benchmark te aksesit per LLU

#### 3.1.1 Tarifate mesatare ne vendet e BE te publikuara nga KE


Te dhënat me te fundit te publikuara nga KE ne lidhje me tarifate aksesit ne rrjete fikse, permbajne te dhena te tarifave me pakice te aksesit broadband (te referuara ne dokumentin “Analize e tregjeve me shumice te aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik”) si dhe te dhena per aksesin ne LLU. Ne lidhje me tarifate per LLU, te dhënat me te fundit te publikuara nga KE i referohen 28 vendeve anëtare te BE per vitin 2013. Tarifa per LLU perfishin pajtimin mujore per aksesin e plote LLU<sup>2</sup>, duke i shtuar dhe 1/36 e tarifave se instalimit. Keto te dhena se bashku me tarifate aktuale te aksesit te plote LLU dhe akse i lote LLU ne nen-qark (Sub-loop) te Albtelecom parqiten ne Figurë 1, me poshte.

---

<sup>1</sup> <https://ec.europa.eu/digital-single-market/download-data>

<sup>2</sup> Akse i plote LLU (Full LLU) eshte rasti kur operatori perfitues merr nga operatori incumbent te gjithe linjen e bakrit nga MDF deri ne banesen e pajtimtarit per te ofruar akses broadband dhe telefoni, ndersa me aksesin e ndare (shared LLU) operatori perfitues ka akses ne linjen e bakrit vetem per sherbimin akses broadband ndersa telefonia ofrohet nga operatori incumbent.

Figura 1: Tarifatat e aksesit te plote ne LLU ne vendet e BE dhe Shqiperi (2013 dhe 2016)



Burimi: EC Digital Agenda for Europe.

Tarifa mesatare ne vendet e BE ne 2013 per aksesin e plote LLU ishte 9.36 euro/muaj, qe perben nje renie shume te vogel me 1% nga tarifa mesatare prej 9.5 euro/muaj ne vitin 2012. Tarifatat ne vendet BE variojনা nga 5.28 euro/muaj ne Lituani ne 15.73 euro/muaj ne Finlande. Tarifatat e Albtelecom per aksesin e plote LLU (ne qark dhe nen-qark local) jane 35-45% me te uleta se niveli mesatar i BE. Tarifatat e Albtelecom jane te krahasueshme me ato te 5 vendeve te BE qe kane tarifen me te ulet dhe nen nivelin 6 euro/muaj.

### 3.1.2. Tarifatat e aksesit te plote dhe te perbashket ne LLU dhe aksesin ne nen-qark (SLU)

Informacioni i dhene ne tabelen e meposhteme eshte marre nga Cullen International dhe eshte me i plote se informacioni i publikuar nga KE i referuar me siper, pasi ai permban te dhena per tarifatat edhe per llojet e tjera te aksesit ne rrjetet fikse, si aksesin i perbashket LLU dhe aksesin LLU ne nen-qark, si dhe perfshin edhe informacion nga vende te rajonit qe nuk jane vende anetare te BE, por me zhvillim dhe kushte ekonomike me te ngjashme me Shqiperine.


Tabela 5: Tarifat e aksesit ne rrjetin local LLU

	Full LLU	Shared LLU	Full SLU	Raporti Full SLU/Full LLU	Raporti Shared LLU/Full LLU
AT	5.87	2.94	4.55	78%	50%
BE	8.03	0.89		0%	11%
BG	7.41	2.51	7.41	100%	34%
CH	11.59		9.58	83%	0%
CY	8.51	1.54	5.45	64%	18%
CZ	6.47	0.96	6.36	98%	15%
DE	10.19	1.78	6.79	67%	17%
DK	7.72	3.86	6.71	87%	50%
EE	5.20	5.20	5.20	100%	100%
ES	8.60	1.30		0%	15%
FI	12.80	7.00		0%	55%
FR	9.10	1.77	9.10	100%	19%
GR	7.61	1.51	5.27	69%	20%
HR	5.73	2.20	4.69	82%	38%
HU	5.74	1.80	3.78	66%	31%
IE	9.91	0.77	9.03	91%	8%
IT	8.68	0.86	5.79	67%	10%
LT	4.92	3.89	4.92	100%	79%
LU	9.47		6.31	67%	0%
LV	8.34	4.79		0%	57%
MK	3.41	1.61		0%	47%
MT	9.37	1.87	6.60	70%	20%
NL	7.92	0.11			1%
NO	8.92	5.14	8.92	100%	58%
PL	5.04	1.33	3.84	76%	26%
PT	8.99	2.51	8.99	100%	28%
RO	6.02	1.11	6.02	100%	18%
SE	10.26	4.00	8.33	81%	39%
SI	7.89	3.19	7.89	100%	40%
SK	4.20	1.33	3.00	71%	32%
TR	4.50	1.69		0%	38%
UK	9.48	0.27	10.16	107%	3%
<b>AVG</b>	<b>7.75</b>	<b>2.32</b>	<b>6.59</b>	<b>85%</b>	<b>30%</b>
AL	5.72	3.34	4.84	85%	58%
<b>Ndryshimi</b>	<b>-26%</b>	<b>44%</b>	<b>-26%</b>	<b>0%</b>	<b>28%</b>

Burimi: Cullen International dhe AKEP

Figurat e mëposhtme paraqesin në mënyrë grafike vlerat e tarifave të aksesit në qarkun e hapur lokal, për akses të plote LLU (Full LLU), akses i përbashkët (Shared LLU) dhe akses i plote në nen-qarkun lokal (Full SLU). Tarifat janë në Euro pa TVSH. Grafiket janë ndërtuar bazuar në informacionin e tabelës së mësipërme të Cullen International.

**Figura 2: Tarifat mujore të aksesit të plote në LLU (2016)**



**Figura 3: Tarifat mujore të aksesit të përbashkët në LLU (2016)**







Figura 4: Tarifate mujore te aksesit te plote ne SLU (2016)



BURIMI: AKEP DHE CULLEN INTERNATIONAL

Krahasimi i tarifave per aksesin LLU me siper tregon se:

- Tarifate mesatare per aksesin ne LLU jane:
  - o 7.75 euro/muaj per aksesin e plote ne Full LLU
  - o 2.32 euro/muaj per aksesin e perbashket (shared LLU)
  - o 6.59 euro/muaj per aksesin e plote ne SLU (nen-qark)
- Tarifate e Altelecom per aksesin e plote ne qarkun dhe nen-qarkun local jane 26% me te uleta e mestarja e vendeve europiane;
- Tarifa e Altelecom per aksesin e perbashket ne qarkun local (shared LLU) jane 44% me te larta se mesatarja e vendeve europiane.

### 3.2 Tarifate benchmark te aksesit ne tubacione

AKEP ne dokumentin “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik*”, te nxjerre ne keshillim publik me 15.06.2016, ne seksionin V.3, ka bere nje analize te tarifave te aksesit ne tubacione ne vendet europiane sipas informacionit te Cullen International. Kjo pjese e analizes se tregut eshte dhene edhe me poshte, duke perfshire informacion shtese, sidmos per tarifat e palikuara ne vendet e rajonit, qe jane me kushte me te ngajshme ekonomike me Shqiperine.

Me qellim krahasimin e tarifave te aplikuara ne Shqiperi per tubacionet me vendet e tjera, AKEP ka marre informacion nga Cullen International. Nga informacionet e marra rezulton se:

1. Detyrimi për të dhënë akses në tuba është vendosur kryesisht si pjesë e detyrimeve në tregun nr.4 (rekomandimi i 2007 të KE), d.m.th në aksesin fizik në infrastrukturë të rrjeteve fikse, përfshirë LLU, në rrjetin lokal të operatorit incumbent deri në pikën e hyrjes në ndërtesë (up to the building entry point)
2. Informacioni për tarifat i referohet aksesit në tubacione në pjesën e rrjetit lokal pra nuk përfshihen tarifat për tuba në rrjet kryesor dhe në shumicën e rasteve janë tarifat të publikuara në ofertën referencë të operatorit incumbent;
3. Tarifat shprehen në varësi të diametrit të tubit dhe/ose në varësi të sipërfaqes së prerjes tërthore të kabllit/tubit, si dhe në disa raste tarifat janë në varësi të vendndodhjes gjeografike të tubit.
4. Në shumë raste aplikohen tarifa one-off për procesimin e kërkesës dhe planin teknik
5. Një faktor i rëndësishëm për stimulimin e përdorimit të përbashkët të tubave është regjistri i infrastrukturës (ATLASI).

Informacioni i përmbledhur për tarifat mujore të aksesit në tubacione në vendet evropiane paraqitet në tabelën dhe figurat e mëposhteme. Tarifat janë në euro/km në muaj. Tarifa minimale i referohet kryesisht tubave me diametër të vogël sipas sqarimeve në dy kolonat e fundit.

Tabela 6: Tarifatat mujore te aksesit ne tubacione ne vendet BE dhe rajonit


Shteti	Minimum monthly fee	Maximum Monthly fee	Min Diameter (mm)	Max Diameter (mm)
AT	850.00	850.00		
BG	25.56	107.37	20	40
CH	132.30	132.30		
CZ	59.17	554.73	40/33 mm	100-120 mm
DE	90.00	90.00	25	
DK	207.76	245.29		
EE	48.00	48.00	30 (tub 100mm i ndare ne 6 seksione me 30mm)	30 (tub 100mm i ndare ne 6 seksione me 30mm)
ES	62.00	62.00	40	40
ES 2	8.00	18.00	per cm <sup>2</sup> ne tub 110 mm	per cm2 ne tub 63 mm
FI	150.00	300.00	zona 3	zona1
FR	21.00	21.00	per CM2 ne segmentin feeder	per cm2 ne segmentin terminues
GR	120.00	120.00		
HR	24.81	152.03	3-16mm	63-110 mm
HU	76.30	76.30		
LT	27.00	27.00		
LU	130.00	130.00		
LV	74.96	74.96		
MK	29.86	77.00	10	40
NO	115.47	829.26	Rurale	City centre
PT	7.50	10.60	ne cm2 zona te tjera	ne cm2 ne Lisbon dhe Porto
SI	266.54	266.54		
SK	922.00	1,900.00		
TR	39.42	60.36	per cm2 ne tub >29mm zone jo metropol apo city centre	per cm2 per dimater >29mm ne zone metropol
UK	40.02	90.87		
AVG ALL	153.03	270.68	Mesatarja e te gjitha vendeve ne table (pa ES 2)	
AVG no Outliers	90.48	121.18	Mesatarja e te gjitha vendeve pa qelizat me hije gri dhe font te kuq	
AVG Region	39.19	94.61	Mesatarja e vendeve me hije te verdhe	
AVG cm <sup>2</sup>	12.17	16.53	Mesatarja e vendeve me tarifa per cm2, me font te kuq	
AVG Cm <sup>2</sup> 20 mm	48.67	66.13	Mesatarja e vendeve me tarifa per cm2 shumezuar me 4	
AVG Region 20-40 mm	67.04	67.04	Mesatarja e tarifave te Maqedonise, Kroacise dhe Turqise per tuba 20-40 mm	
Albtelecom 20 mm	100.00	200.00		

Burimi: Cullen International Prill 2016 dhe AKEP

Sic mund te vihet re nga tabela dhe nga grafiket e meposhtem, niveli i tarifave ka diapazon shumë të madh dhe mënyra e tarifimit ka variacione të mëdha dhe eshte komplekse. Meqenese kostot e ndertimit te infrastruktures se tubacioneve (dhe rrjedhimisht tarifes se aksesit per perdorim te perbashket) varen ne mase te madhe nga kostot e puneve civile, eshte e arsyeshme qe ne krahasimin e tarifave te merret ne konsiderate edhe mesatarja e vendeve te rajonit. Njekohesisht ne tablete tarifate paraqitura per disa vende jane te shprehura ne euro per km dhe

cm2, praktike tarifimi e cila perdoret kryesisht per rastet kur ne nje tub bashkevendosen disa kablllo (te nje apo disa operatoreve) me diameter me te vogel se i tubit.

**Figura 5: Tarifate minimale mujore per akses ne tub**



Burimi: Te dhena nga Cullen International

**Figura 6: Tarifate maksimale mujore per akses ne tub**



Burimi: Te dhena nga Cullen International

Bazuar ne te dhenat e mesiperme AKEP ne tabelle ka perfshire tarifate mesatare si me poshte:

1. AVG ALL: Tarifa mesatare te te gjithave vendeve te paraqitura ne tabelle

2. AVG no Outliers: Tarifa mesatare e te gjithave vendeve te paraqitura ne tabele pa vendet qe kane tarifa qe jane dukshem shume te larta si Austria, Cekia, Norvegjia dhe Sllovakia ( te evidentuara me kolona te kuqe ne grafiket e mesiperm) dhe vendet qe kane tarifat te shprehuara ne km dhe cm<sup>2</sup> (Franca, Portugalia dhe Spanja (ES2)).
3. AVG Region: Tarifa mesatare e Maqedonise, Kroacise, Bullgarise, Turqise dhe Hungarise.
4. AVG cm<sup>2</sup>: Tarifa mesatare (euro per cm<sup>2</sup> dhe km) e aksesit ne tubacione e Frances, Portugalise dhe Spanjes (ES2)
5. AVG cm<sup>2</sup> 20 mm: Tarifa mesatare ne euro per cm<sup>2</sup> dhe km (pika 4 me siper) shumezuar me 4, per te llogaritur tarifen per nje kabell 20 mm. Eshte perdorur koeficienti 4 si diametri ne cm ne katror dhe jo siperfaqja e prerjes terthore te kabllit ( $\pi r^2$ ) per te lehuar per siperfaqe te lire ne tub.
6. AVG Region 20-40 mm: Tarifa mesatare e aksesit ne tuba 20-40 mm e aplikuar ne Maqedoni, Kroaci dhe Turqi.

Tabela e meposhteme paraqet nje informacion me te detajuar te tarifave te aksesit ne tubacione te aplikuar ne vendet e rajonit, ne te cilat AKEP ka shtuar edhe informacion te marre kohet e fundit per Malin e Zi.

Tabela 7: Tarifatat mujore te aksesit ne tubacione ne vendet e rajonit

	Diametri i Tubit	Tarifa Mujore (Euro/km)
Kroacia	3-16 mm	26
	20-40 mm	46
	50 mm	133
	63-110 mm	158
Maqedonia	5 mm	20
		29
	10 mm	29
	32 mm	61
	40 mm	77
Turqia	29 mm	60
		92
Mali i Zi	20mm	30
	40 mm	81
AVG Region 1	20-40 mm	64
AVG Region 2	20 mm	49
AVG Region 3	40 mm	74
Albtelecom	20 mm	100-200

Nga te dhenat e tabelave te mesiperme dhe tarifatat e aplikuara nga Albtelecom vihet re se:

- Tarifatat e Albtelecom fillojne me nivelin 200 euro/km ne muaj per nje kabell me diameter 20 mm per 1000 metrat e para dhe me pas pershkallezohen duke u reduktuar deri ne 100 euro/km per distancat mbi 300 km.
- Tarifatat ne disa vende jane shume me te larta se mesatarja dhe ne disa vende jane te shprehura edhe per cm<sup>2</sup>, dhe ne kete menyre me e pershtashme eshte krahasimi me AVG No Outliers se sa me AVG ALL.
- Tarifatat e Albtelecom per kablllo 20 mm jane me te larta se mesatarja e te gjitha vendeve AVG no Outliers (ku perfshihen edhe vende me kosto te puneve civile disa here me te larta se ne Shqiperi) dhe disa here me te larta se sa tarifatat ne vendet e rajonit per akses ne tuba 20-40 mm (49-67 Euro/km).

Krahasimi i mesiperm tregon se tarifat e Albtelecom per aksesin ne tubacione jane shume me te larta se vendet e rajonit, e cila con ne perdorim te kufizuar te perbashket te tubave dhe pjeseve produkteteve/sherbimeve te tjera baze te infratsruktures aktive te Albtelecom. AKEP nuk ka informacion per tarifat e aplikuar nga ATU, pasi keto cmime aktualisht rezultojne te jene objekt i negociatave komerciale dhe nuk jane te publikuar ne ndonje dokument te ATU.

## 4. Rregullimi i tarifave me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fikse ne Shqiperi

---

Sipas nenit 57 te ligjit 9918, **Metoda e rregullimit të tarifave:**

1. *AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:*

a) *përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;*

b) *korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:*

i) *kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;*

ii) *raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;*

iii) *procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efiçente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;*

c) *përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.*

2. *Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:*

a) *praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;*

b) *tarifat mesatare të vendeve të BE-së;*

c) *tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;*

ç) *raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;*

d) *normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.*

3. *Metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.*

4. *Sipërmarrësit, që kanë detyrimin për të zbatuar detyrimet e veçanta dhe rregullimin e tarifave, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 56, duhet të aplikojnë paraprakisht në AKEP për miratimin e tarifave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave.*

5. *AKEP-i ose një ekspertizë kontabël e pavarur e përzgjedhur nga ajo, verifikon përputhshmërinë e tarifave nën rregullim me metodën dhe kushtet e përcaktuara për rregullimin e tarifave.*

Sipas percaktimeve te mesiperme dhe perfundimeve te analizes se tregut dhe ketij dokumenti ne kapitujt e meparshem, AKEP ne seksionet ne vijim propozon metoden e rregullimit te tarifave per sherbimet e Albtelecom dhe ATU, per sherbimet perkatese per te cilat jane propozuar per



status me FNT ne dokumentin “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Keshillim Publik*”, te nxjerre ne keshillim public me 15.06.2016.

#### **4.1. Tarifat per LLU (Tregu WLA): Albtelecom**

Sipas perkufizimit te tregut perkates ne dokumentin e analizes se tregut, sherbimet kryesore te ofruara nga Albtelecom per kete treg jane aksesi ne LLU dhe sherbimet shoqeruese te aksesit ne tubacione ne nivel local/urban, per lidhje te pikes se intrekoneksionit/lidhjes se operatorit perfitues me Albetelcom me MSAN perkates. Tarifat aktuale te Albtelecom per aksesin ne qarkun e hapur local jane percaktuar nga AKEP ne Analizen e tregut ne vitin 2014, ne te cilen AKEP ka percaktuar se Albtelcom duhet te vazhdoje te aplikojte tarifate e miratuara me VKD nr.1365, date 13.04.2011, duke saktësuar qe per linjat e aksesuara ne MSAN per LLU, Albtelecom te aplikojte tarifate perkatese te aksesit (te plote dhe te perbashket) në nën-rrjetin lokal. Migrimi ne rrjetin NGA, me modelin FTTN, nga Albtelcom con ne zvogelimin e rrjetit te aksesit dhe qarqeve locale (local loops), dhe praktikisht ato mund te konsiderohen sub-loops: lidhja MSAN perdorues fundor me linje bakri.

Keto tarifa te Albtelecom jane bazuar ne rezultatet e modelit BULRAIC te vitit 2010, te kryer nga AKEP me konsulence nderkomebatore. Modeli ne vitin 2010 eshte bazuar ne strukturen e rrjetit PSTN dhe jo ne NGN/NGA qe aktualisht ka Albtelecom. Aplikimi i tarifave se nen-qarkut local per akses ne qarkun LLU ne MSAN, eshte konsideruar nga AKEP si nje peraftrim me i mire i kostos se aksesit ne qarkun local ne kushtet e migrimit te plote te Albtelecom ne NGA (zveglimi i gjatesise se qarkut local), megjithese teknikisht nen-qarku local (sub-loop) eshte i ndryshem nga qarku qe lidh perdoruesin fundor me MSAN.

AKEP gjykon se tarifate e Albtelecom per aksesin ne qarkun local, kane neville te rishikohen. Me perfundimin e migrimit te rrjetit ne NGN/NGA, tarifate per aksesin e plote dhe te ndare (perbashket) ne qarkun local duhet te kene refence me ato ne nen-qarkun local.

Ne rregullimin e tarifave me shumice, nje kujdes i vecante duhet treguar ne raportin e ketyre tarifave me tarifate e sherbimeve perkatese apo te krahasueshme me pakice. Tarifa e aksesit ne qarkun local (LLU) eshte tarife me shumice dhe krahasimi me i mire eshte me tarifate fikse mujore me pakice per sherbime telefonie dhe aksesi ne Internet. Ne sherbimet me pakice

Albtelecom ofron nje sere paketash tarifore, qe kreysisht jane te fokusuara ne sherbime te integruara (bundles). Nje nder keto paketa eshte edhe paketa familjare standard, e cila ofron sherbim telefonik (duke perfshire dhe minuta falas) si dhe akses ne Internet per nje tarife fikse mujore prej 700 lek/muaj me TVSH. Krahasimi i kesaj tarife me pakice me tarifen me shumice per aksesin ne nen-qarkun lokal (full SLU) te Albtelecom (678 lek/muaj pa TVSH) tregon se tarifa me shumice eshte me larte se tarifa me pakice.

### **Metoda e rregullimit**

AKEP propozon qe tarifat me shumice e aksesit ne qarkun lokal (LLU) te Albtelecom te rishikohen/rregullohen ne vazhdim, sipas metodes se percaktimit te cmimit maksimal dhe duke marre ne konsiderate raprotimn e cmimeve me shumice dhe me pakice dhe tarifat ne vendet e tjera. Tabela e meposhteme parqet propozozimin e AKEP per rregullimin ketyre tarifave, duke filluar nga 1.01.2017.

**Tabela 8: Tarifat me shumice te Albtelecom per aksesin LLU (2017)**

Shërbimi	Tarifa Aktuale	Tarifa e Re Maksimale (1.01.2017)	Ndryshimi %
<b>Akses i plote në rrjetin lokal (LLU)-MSAN</b>	678	<b>486</b>	-28%
<b>Akes i perbashket në rrjetin lokal (LLU)-MSAN</b>	407	<b>292</b>	-28%
Pagesa instalimi për LLU			
<b>Instalimi I aksesit te plote ne rrjetin lokal</b>	1,686	<b>1,686</b>	0%
<b>Instalimi I aksesit te perbashket në rrjetin lokal të hapur</b>	2,452	<b>2,452</b>	0%

*Shenim: Tarifat ne LEK pa TVSH*

Tarifat mujore te aksesit ne LLU ne nivel MSAN propozohet te reduktohen me 28% nga niveli actual. Tarifa e re me shumice e aksesit te plote ne nen-qarkun lokal (qark lokal ne nivel MSAN) eshte derivuar nga tarifa me pakice e pajtimit mujor per paketen “Familjare” 583 lek/muaj pa TVSH (700 lek me TVSH), duke aplikuar nje zbritje me 20% ne kete tarife, pra duke krijuar nje marzh me 20% midis tarifes me pakice dhe tarifes me shumice. Ky ndryshim con ne reduktim prej 28% te tarifes se aksesit te plote ne nen-qarkun lokal (qark lokal ne nivel MSAN), dhe ky nivel reduktimi eshte aplikuar pastaj edhe per tarifen e aksesit te perbashket ne nen-qarkun lokal (qark lokal ne nivel MSAN).

Rregullimi i tarifave per aksesin ne tubacione trajtohen ne Seksionin 4.4.

## 4.2. Tarifat per aksesin bitstream (Tregu WCA): Albtelecom

### Metoda e rregullimit

Per rregullimin e tarifave te aksesit bitstream, AKEP propozon te vazhdoje rregullimin me metoden ‘Retail minus’ si ne vitin 2014 sipas koeficienteve te dhene ne table e meposhteme, si dhe vlerave maksimale sipas Tabeles 10.

**Tabela 9: Metoda e rregullimit te tarifave te aksesit bitstream te Albtelecom (2016)**

Niveli i aksesit	Cmimi Maksimal
Ne nivel ATM/Ethernet;	Tarifa Retail - 50%
Ne nivel IP	Tarifa Retail - 30%

*Shenim: Tarifa retail me pakice pa TVSH*

Tabela 10, me poshte paraqet nivelin maksimal te tarifave me shumice per aksesin bitstream, ne nivel ATM/Ethernet dhe ne nivel IP, per t’u aplikuar nga Albtelecom.

**Tabela 10: Tarifat maksimale mujore te aksesit bitstream te Albtelecom (2016-)**

Shpejtesia Doënload	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
<b>2 Mbps</b>	468	421	549	494
<b>4 Mbps</b>	623	560	731	658
<b>6 Mbps</b>	828	745	972	875
<b>8 Mbps</b>	1,101	991	1,293	1,164
<b>10 Mbps</b>	1,266	1,139	1,487	1,338
<b>12Mbps</b>	1,456	1,310	1,710	1,539
<b>16 Mbps</b>	1,675	1,508	1,966	1,769

*Shenim: Tarifat ne Lek pa TVSH*

### 4.3 Tarifat per Linjat me qira (Tregu WHQA): Albtelecom

Ne lidhje me rregullimin e tarifave per sherbimet e tregut me shumice aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA), qe kryesiht permabn sherbimet e linjave me qira, AKEP propozon vazhdimin e rregullimit si ne vitin 2014 te aksesit me shumice ne Ethernet ne rrjetin NGN dhe rrjet tradicional, pra qe tarifate e Albtelecom per kapacitetet me qira Ethernet ne rrjet tradicional dhe Ethernet ne NGN duhet:

- Te mos jene me te larta se tarifate e tabelave se mesiperme;
- Te jene te pakten 20% me te lira se tarifate sherbimeve respektive me pakice.

AKEP ne dokumentin e analizes se tregut 2016 (keshillimim public), ka vene theksin kryesor ne rregullimin e infrastruktures pasive (tubacione etj) dhe per kete arsye edhe ne rregullimin e tarifave theksi me i madh i kushtohet rregullimit te tarifave te perdorimit te perbashket te tubacioneve apo aksesit ne elementet pasive te infrastruktures, per shkak se ky rregullim sjell rritje te stimujve per investime/konkurrence me te madhe ne infrastrukturate aktive, reduktim te kostove te rrjeteve broadband dhe perfundimisht sherbime me cilesi me larte te aksesit broadband dhe kosto me te ulet per perdoruesit fundore, konsumatore dhe biznes.

### 4.4 Tarifate e aksesit ne Tubacione: Albtelecom dhe ATU

Tarifate e aksesit ne tubacione nuk kane qene nen-rregullim ex-ante nga AKEP. Ato propozohen te vihen nen-rregullim nepermjet procesit te analizes se tregut, dhe vendimeve perkatese qe do te merren nga AKEP ne perfundim te keshillimit public te dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik*”, i publikuar me 15.06.2016.

#### **Metoda e rregullimit**

Ne baze te perfundimeve te analizes se tregut dhe te ketij dokumenti, AKEP propozon qe tarifate e aksesit ne tubacione (perdorim i perbashket) te Albtelecom (ne nivel lokal dhe kombetare) dhe ATU (ne nivel kombetar), te rregullohen sipas metodave se percaktimit te **cmimit maksimal**,

duke marre ne konsiderate **tarifat mesatare (benchmark) te aplikuara ne vendet e BE dhe rajonit**, me zhvillim te ngjashem me Shqiperine.

**Tabela 11: Tarifat maksimale te aksesit ne tubacione per Albtelecom dhe ATU (1.01.2017)**

Diametri i Tubit/kablilit	Tarifa Fillestare (Euro/km)	Tarifa Mujore (Euro/km)
20 mm	100	50
40 mm	100	75
D cm <sup>2</sup>	100	12.5xD <sup>2</sup>

Rreshti 3 i referohet tarifes se aksesit per kabllo me diameter D per Cm<sup>2</sup>, llogariteti si D<sup>2</sup>x12.5:

- D: Diametri ne cm i kablilit qe do vendoset ne tub
- 12.5: tarifa mujore per cm<sup>2</sup>

Tarifa 50 Euro/km per tub/kabell 20 mm eshte vendosur bazuar ne tarifen mesatare te rajonit per tuba 20mm (*AVG Region 2, Tabela 7*), si dhe ne tarifen mesatare te vendeve te BE qe aplikojne tarife euro/km per cm<sup>2</sup> (*AVG cm<sup>2</sup>, tub 20 mm, Tabela 6*).

Tarifa 75 euro/km per tub 40 mm eshte vendosur bazuar ne tarifen mesatare te rajonit per tuba 20mm (*AVG Region 3, Tabela 7*).

Tarifa 12.5 euro/cm<sup>2</sup> eshte vendosur bazuar ne tarifen mesatare te vendeve te BE qe aplikojne tarife euro/km per cm<sup>2</sup> (*AVG cm<sup>2</sup>, Tabela 6*). Kjo tarife propozohet te perdoret per kabllo/tuba me diameter te ndryshem nga 20 dhe 40 mm.

Tabela e meposhteme paraqet ndryshimin e tarifave aktuale te aplikuara nga Albtelecom me tarifat e reja te propozuara nga AKEP per te filluar aplikimin nga data 1.01.2017. Tarifat jane per vendosjen e nje kablli me diameter 20 mm te operatorit perfitues ne tub me diameter 100 mm te Albtelecom.

Tabela 12: Ndryshimi i Tarifave te aksesit ne tubacione ne rrjetin Albtelecom (kabell 20 mm)


	Distanca (Km)	Tarifat Aktuale		Tarifat e reja (1.01.2017)		Ndryshimi i tarifes Mujore
		Tarife Fillestare Euro/Km	Tarifa Mujore Euro/km Muaj	Tarife Fillestare Euro/Km	Tarifa Mujore Euro/km Muaj	
D1	0.2-1	100	200	100	50	-75%
D2	1-5	80	160	100	50	-69%
D3	5-20	80	150	100	50	-67%
D4	20-40	80	140	100	50	-64%
D5	40-80	80	130	100	50	-62%
D6	80-160	80	120	100	50	-58%
D7	160-300	80	110	100	50	-55%
D8	>300	80	100	100	50	-50%

Shenim: Tarifat ne Euro pa TVSH

## 5. Efektet e pritshme

Figurat e mëposhtëme paraqesin krahasimin e tarifave të aksesit LLU (sub-loop), aksesit në tubacione në Shqipëri (aktuale dhe të propozuara nga AKEP në këtë dokument për vitin 2017) dhe tarifave në vendet e BE dhe rajonit.

Figura 7: Tarifat aksesit LLU në nen-rrjetin lokal (2016-2017)




Burimi: Te dhena nga Cullen International dhe AKEP

Figura 8: Tarifat minimale mujore për akses në tub 2016-2017



Burimi: Te dhena nga Cullen International dhe AKEP

Figura 9: Tarifatat maksimale mujore per akses ne tub 2016-2017



Burimi: Te dhena nga Cullen International dhe AKEP

Propozimi i AKEP ne kete dokument eshte per nje reduktim me 28% te tarifave te aksesit LLU dhe me 50-75% te tarifave te aksesit ne tubcione. Me keto ndryshime qe propozohet te hyjne n efuqi me 1.01.2017, niveli i tarifave te aksesit LLU eshte nder nivelet me te uleta ne vendet e BE dhe rajonit (vetem Sllovakia ka tarife me te ulet), dhe niveli i tarifave te aksesit ne tubacione barazohet me mesataren e vendeve te rajonit dhe vendeve te BE me tarifa me te uleta.

Nepermjet propozimeve ne kete document per rregullimin e tarifave te aksesit ne rrjetet fikse, AKEP synon realizimin e objektivave te ligjit 9918, per nxitjen e konkurrences per sherbimet e aksesit broadband. AKEP pret qe kjo te realizohet nepermjet reduktimit te kostove te ndertimit te rrjeteve broadband dhe ofrimit te sherbimeve te aksesit broadband per perdoruesit fundore, konsumatore dhe biznes, dhe njekohesisht rritjen e cilesises se ketyre sherbimeve. Ne menyre me specifike rregullimi i propozuar i tarifave, pritet te nxise:

- perdorimin e infrastruktures aktuale dhe te re te mundshme te rrjetit lokal te Albtelecom, duke reduktuar ekzistencen e shume rrjeteve lokale fikse paralele;
- perdorimin e perbashket te infrastruktures pasive (tubacione), ne zona urbane dhe nder-urbane te Albtelcom dhe ATU, dhe kjo te coje ne rritje te zgjerimit et zonave te mbulimit me rrjete broadband;



- rritjen e cilesise dhe sigurise se rrjeteve broadband nepermjet perdorimit me te madh te rrjeteve nen-tokesore dhe zvogelimin e rrjeteve ajrore te pasigurta.

Rregullimi i tarifave te aksesit ne tubacione dhe niveli i rregulluar i tyre per Albtelcom dhe ATU, pritet te sherbejne edhe si cmime reference per ofrues te tjere te tubacioneve, perfshire Bashkite dhe institucione te transportit rrugor, qe kane investuar ne shtrirjen e tubacioneve gjate procesve te ndertimit te rrugeve te reja apo rehabilitimit te tyre.

Rregullimi i propozuar nga AKEP konsiston ne perdorimin e metodes se cmimit maksimal, bazuar ne tarifat benchmark te vendeve te rajonit per aksesin ne tubacione, per shkak edhe te mungeses se informacionit per kostot e ofrimit eficient te ketyre sherbimeve. Kjo metode vleresohet e pershtatshme dhe e arsyeshme nga AKEP, dhe nese operatoret nen-rregullim kane pretendime per nivelin e tarifave dhe kostove, duhet te argumentojne llogaritjen e kostove sipas parimeve te rregullores se AKEP per ndarjen se llogarive dhe llogaritjen e kostove.

# Aneks 1: Pyetjet e keshillimit publik

---

Me poshte eshte nje permbledhje e pyetjeve per te cilat AKEP eshte i interesuar te marre komente nga palet e interesuara. Ne pergjigjet e dhena per pyetjet, palet jane te lutura te perfshijne edhe argumentim per pergjigjet/komentet. Palet mund te japin komente edhe per pjese te tjera te dokumentit te nxjerre ne keshillim dhe propozimeve te AKEP, apo dhe sugjerime shtese per nje rregullim sa me te mire te tarifave me shumice per sherbimet e aksesit broadband dhe te te dhenave.

1. A jane pasqyruar drejt tarifat benchmark te vendeve te BE dhe rajonit pe sherbimet e LLU dhe aksesit ne tubacione ne **Seksionin 3**?
2. A jeni dakort me propozimin e AKEP per reduktimin e tarifave te sherbimeve te LLU te Albtelecom me 28% dhe mendoni se ky reduktim do te rrise/krijoje interes per perdorimin e ketyre sherbimeve nga operatoret e tjere?
3. Cfare mendoni per propozimin e AKEP per rregullimin e tarifave te aksesit bitstream te Albtelecom dhe vazhdimin e rregullimit te tyre me metoden “Retail minus”?
4. Cili eshte opinioni juaj ne lidhje me rregullimin e propozuar te tarifave te aksesit ne tubacione te Albtelecom dhe ATU:
  - i. A perbejne tarifat e aksesit ne tubacione te vendeve te rajonit nje reference/benchmark me te mire dhe te arsyshem per tarifat ne Shqiperi?
  - ii. A mendoni se rregullimi i ketyre tarifave me metoden benchmark eshte i pershtatshem apo duhet te perdoren modele te kostove?
  - iii. A mendoni se reduktimi i ketyre tarifave do te sjelle rritje te ndjeshme te perdorimit te tyre dhe rritje te konkurrences ne tregun me pakice te aksesit broadband?

## Aneks 2: Lista e Shkurtimeve të Shteteve

---

<b>Simboli</b>	<b>Shteti</b>
<b>AT</b>	Austri
<b>BE</b>	Belgjik
<b>BG</b>	Bullgari
<b>CH</b>	Zvicër
<b>CY</b>	Qipro
<b>CZ</b>	Çeki
<b>DK</b>	Danimarkë
<b>DE</b>	Gjermani
<b>EE</b>	Estoni
<b>EL</b>	Greqi
<b>ES</b>	Spanje
<b>FI</b>	Finlandë
<b>FR</b>	Francë
<b>HR</b>	Kroaci
<b>HU</b>	Hungari
<b>IE</b>	Irlandë
<b>IS</b>	Islandë
<b>IT</b>	Itali
<b>LT</b>	Lituani
<b>LV</b>	Letoni
<b>LU</b>	Luksemburg
<b>FYROM</b>	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
<b>NL</b>	Hollandë
<b>NO</b>	Norvegji
<b>PL</b>	Poloni
<b>PT</b>	Portugali
<b>RO</b>	Rumani
<b>RS</b>	Serbi
<b>SE</b>	Suedi
<b>SI</b>	Slloveni
<b>SK</b>	Sllovaki
<b>TR</b>	Turqi
<b>UK</b>	Mbreteria e Bashkua(Angli)